

- потпише договор за практикантска работа со содржина спротивна на одредбите од овој закон (член 13),
 - не ја прими писмената изјава за раскинување на договорот за практикантска работа, не го раскине договорот за практикантска работа во дадениот рок, го раскине договорот за практикантска работа спротивно на овој закон (член 14 ставови (2) и (3)) и
 - неправилно води или не води евиденција на работните часови на практикантот (член 15).

(2) Глоба во износ од 30% од одмерената глоба за правното лице ќе му се изрече за прекршокот од ставот (1) на овој член и на одговорното лице во правното лице.

(3) Глоба во износ од 150 до 250 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за прекршокот од ставот (1) на овој член на работодавач-физичко лице.

Глоба за овластено службено лице

Член 21

Глоба во износ од 50 до 100 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за прекршок на овластеното службено лице од органот кој ја води постапката и надлежниот јавен орган од кој се побарани доказите и податоците, ако:

- не води евиденција за работните часови на практикантот согласно со овој закон (член 15).

Порамнување

Член 22

(1) Доколку при вршење на инспекциски надзор над примената на овој закон се утврди повреда која е пропишана како прекршок со овој закон, од страна на овластеното службено лице задолжително ќе му се понуди постапка за порамнување на сторителот на прекршокот согласно со Законот за прекршоците.

(2) Формата и содржината на прекршочниот платен налог и мандатен платен налог ги пропишува министерот надлежен за работите од областа на трудот.

Одмерување на глоба

Член 23

Одмерување на висината на глобата за правното лице се врши согласно со Законот за прекршоците.

Водење прекршочна постапка

Член 24

(1) За прекршоците од членот 20 од овој закон, прекршочна постапка води и прекршочна санкција изрекува прекршочниот орган - Прекршочна комисија, во рамките на министерството надлежно за работите од областа на трудот.

(2) За прекршоците од членот 21 од овој закон, надлежниот орган ќе издаде мандатен платен налог согласно со Законот за прекршоците.

IX. Преодни и завршни одредби

Член 25

Подзаконските прописи предвидени со овој закон ќе се донесат во рок од три месеци од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 26

Подзаконските акти од членот 19 став (2) и членот 22 став (2) од овој закон ќе се донесат во рок од 15 дена од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 27

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“.

L I G J PËR PRAKTIKË

I. Dispozita të përgjithshme

Lënda e ligjit

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet procedura dhe kushtet për realizimin e praktikës, të drejtat dhe obligimet e praktikantit dhe të punëdhënësit tek i cili realizohet puna e praktikantit, marrëveshja për punë të praktikantit dhe evidenca e punës së praktikantit.

Përkufizime

Neni 2

(1) Shprehje të ndryshme të përdorura në këtë ligj e kanë domethënie si vijon:

1. "Praktikë" është aktivitet pune i cili përfshin komponentin e punës nëpërmjet mësimit dhe fitimit të shkathtësive praktike të punës, e cila realizohet në periudhë kohore të kufizuar, me qëllim fitimin e përvojës praktike dhe profesionale me qëllim të përmirësohet punësimi dhe të ndihmohet kalimi në punësim të rregullt. Me praktikë nuk nënkuptohet kryerja e stazhit të praktikantit, stazhi vullnetar dhe puna provuese në pajtim me Ligjin për marrëdhëniet e punës, si dhe trajnimi, rikualifikimi dhe kualifikimi plotësues në pajtim me Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë.

2. "Puna e praktikantit" është periudhë e kufizuar e kaluar në praktikë e praktikantit tek punëdhënësi.

3. "Praktikant" është person fizik i cili kryen punë praktikantit te punëdhënësi me qëllim të fitojë njohuri praktike dhe shkathtësi të cilat do t'i ndihmojnë të përmirësojë punësimin në tregun e punës.

Praktikant në pajtim me këtë ligj mund të jetë çdo person fizik, shtetas i Republikës së Maqedonisë i cili i plotëson kushtet e përcaktuara me këtë ligj.

4. "Punëdhënëс" është person juridik ose fizik, si dhe subjekt tjetër (organ i pushtetit shtetëror, organ i njësisë së vetëqeverisjes lokale, filial i shoqatës së huaj, përfaqësi diplomatike konsullore), i cili punëson punëtorë në bazë të marrëveshjes për punësim.

5. "Mentor" është person i punësuar te punëdhënësi i cili është i angazhuar për organizimin e punës së praktikantit dhe ndjekjen e progresit të praktikantit dhe i cili siguron realizimin e qëllimeve për mësim gjatë punës së praktikantit.

(2) Shprehjet e përdorura "praktikant", "mentor" dhe "punëdhënëс" në gjininë mashkullore kanë domethënie neutrale dhe vlejnë edhe për femra edhe për meshkuj.

II. Kushte për kryerjen e punës së praktikantit**Kushte për kryerjen e punës së praktikantit****Neni 3**

Praktikanti në pajtim me këtë ligj duhet t'i plotësojë kushtet si vijon:

- të mos jetë në marrëdhënie pune,
- të mos jetë më i moshuar se 34 vjeç dhe
- të ketë kryer së paku arsimin fillor.

Neni 4

(1) Nevojën për praktikant punëdhënësi e siguron me anë të konkursit publik të publikuar në internet faqen e tij dhe/ose në internet faqen e Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë ose në media tjetër publike, që përmban informata për kushtet për punën e praktikantit.

(2) Në organet e pushtetit shtetëror dhe organet e njësisë së vetëqeverisjes lokale gjatë angazhimit të praktikantëve, zbatohet parimi i përfaqësimit të drejtë dhe adekuat i pjesëtarëve të bashkësive dhe pjesëmarrja e balancuar gjinore.

Neni 5

(1) Me zbatimin e këtij ligji ndalohet çdo diskriminim mbi bazë të rasës, ngjyrës së lëkurës, përkatësisë nacionale ose etnike, seksit, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, përkatësisë në grup të marginalizuar, gjuhës, shtetësisë, origjinës sociale, arsimit, religjionit ose bindjes fetare, bindjes politike, bindjes tjetër, pengesës, moshës, gjendjes familjare ose martesore, statusit pronësor, gjendjes shëndetësore, vetisë personale dhe statusit shoqëror ose cilës do bazë tjetër.

(2) Mbrojtja nga diskriminimi sigurohet në pajtim me Ligjin për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi.

Kohëzgjatja e punës së praktikantit**Neni 6**

(1) Periudha e kohëzgjatjes së punës së praktikantit të një punëdhënësi mund të zgjatë deri në gjashtë muaj.

(2) Te punëdhënësi i njëjtë puna e praktikantit mund të kryhet vetëm një herë nga personi i njëjtë.

Numri i praktikantëve**Neni 7**

(1) Numri maksimal i praktikantëve të cilët mund të realizojnë punë të praktikantit të një punëdhënësi në të njëjtën kohë, përcaktohet sipas numrit të të punësuarve në kohë të papërcaktuar në ditën e paraqitjes së praktikantit te punëdhënësi, si vijon:

- nga një deri në pesë të punësuar - një praktikant,
- nga gjashtë deri në 10 të punësuar - deri në dy praktikantë,
- nga 11 deri në 50 të punësuar - deri në katër praktikantë,
- prej 51 deri në 150 të punësuar - deri në tetë praktikantë,
- nga 151 deri në 250 të punësuar - deri në 15 praktikantë,
- prej 251 deri në 500 të punësuar - deri në 30 praktikantë dhe
- mbi 500 të punësuar - deri në 50 praktikantë.

(2) Numri i praktikantëve të angazhuar nga punëdhënësi në cilin do moment nuk guxon të kalojë numrin maksimal i cili është përcaktuar në bazë të numrit të të punësuarve në kohë të papërcaktuar te punëdhënësi në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni.

(3) Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë një herë në muaj dorëzon të dhëna te Inspektorati Shtetëror i Punës për punëdhënësit të cilët kanë paraqitur praktikantë.

Kompensim për punën e praktikantit**Neni 8**

(1) Praktikanti gjatë kohës së punës së praktikantit te punëdhënësi ka të drejtë për kompensim mujor i cili paguhet nga punëdhënësi.

(2) Lartësia e kompensimit mujor nga paragrafi (1) në këtë nen përcaktohet në neto shumë për orar të plotë të punës në varësi të kohëzgjatjes së periudhës së punës së praktikantit, si vijon:

- prej 42% deri në 74% të neto pagës minimale, e përcaktuar në pajtim me ligjin, për punën e praktikantit deri në tre muaj dhe

- në lartësi të neto pagës minimale të përcaktuar në pajtim me ligjin, për punë të praktikantit mbi tre muaj, llogaritur nga muaji i katërt.

(3) Nëse puna e praktikantit, në pajtim me marrëveshjen për punë të praktikantit, realizohet në periudhë më të shkurtë se orari i plotë i punës, kompensimi për punën e praktikantit do të përlllogaritet në mënyrë proporcionale për kohën e kaluar në punë të praktikantit.

(4) Në rast të mungesës nga puna për çfarë do lloj baze, përpos pushim gjatë punës dhe festave të përcaktuar me ligj, mungesa paguhet në mënyrë proporcionale me kohën e kaluar në punë të praktikantit.

(5) Kompensimin për punë të praktikantit, praktikantit, punëdhënësi është i obliguar t'ia paguajë më së voni deri më 15 të muajit rrjedhës për muajin e kaluar.

III. Të drejta dhe obligime të praktikantit dhe punëdhënësit**Të drejtat e praktikantit****Neni 9**

Praktikanti, para fillimit të punës së praktikantit duhet të informohet për të drejtat gjatë kryerjes së punës së praktikantit, si vijon:

- në formë të shkruar të marrë përshkrimin e qëllimeve, detyrave dhe procesin e praktikës, para se të lidhë marrëveshjen për punë të praktikantit,

- të njoftohet me kushtet për punë dhe rreziqet në lidhje me punën gjatë praktikës, para fillimit të saj,

- të njoftohet me aktet e përgjithshme të punëdhënësit,
- për pushimin ditor dhe javor njëjloj si të punësuarit te punëdhënësi në pajtim me dispozitat e përgjithshme për marrëdhënie pune,

- për pushimin e paguar në kohëzgjatje prej dy ditë pune në muaj, nëse punon me orar të plotë të punës ose një ditë në muaj nëse punon me orar jo të plotë të punës,

- për kompensimin për punë të praktikantit nga neni 8 i këtij ligji dhe

- kompensimin për shpenzimet për udhëtime zyrtare dhe kompensime të tjera të cilat janë shkaktuar për nevojat e kryerjes së punës së praktikantit.

Obligimet e praktikantit

Neni 10

(1) Praktikanti gjatë punës së praktikantit është i obliguar që:

- të nënshkruajë marrëveshje për punë të praktikantit me punëdhënësin, para fillimit të punës së praktikantit,
- të punojë në pajtim me ligjin, marrëveshjen për punë të praktikantit dhe aktet e përgjithshme të punëdhënësit me të cilat paraprakisht është njoftuar,
- të marrë pjesë në trajnim dhe me përkushtim të punojë në detyrat që i janë besuar:
- të përdorë mjete për mbrojtje gjatë punës, në pajtim me dispozitat për siguri dhe shëndet gjatë punës,
- ta njoftojë punëdhënësin për sëmundje ose shkaqe të tjera për pengimin e përkohshëm ose të përhershëm për kryerjen e punës së praktikantit,
- t'i ruajë të dhënat e besueshme, respektivisht informatat e klasifikuara të punëdhënësit, me të cilat është njoftuar gjatë punës së praktikantit dhe
- ta njoftojë punëdhënësin për pasojat e dëmshme për të cilat është i njoftuar se mund të shkaktohen për të, për persona të tretë ose për punëdhënësin.

(2) Praktikanti i cili gjatë kohës së kryerjes së punës së praktikantit me qëllim ose për shkak të moskujdesit të skajshëm, ka dëmtuar pronën e punëdhënësit, është i obliguar t'ia kompensojë dëmin punëdhënësit në pajtim me Ligjin për marrëdhënie obliguese.

(3) Nëse praktikanti paraprakisht e ka njoftuar punëdhënësin për pasojat e dëmshme nga paragrafi (1) alineja 7 të këtij neni, i njëjti nuk do të ketë përgjegjësi për dëmin e shkakuar.

Obligimet e punëdhënësit

Neni 11

(1) Punëdhënësi është i obliguar që:

- të shpallë konkurs publik për punë të praktikantit në internet faqen e tij dhe/ose të internet faqen e Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë ose në media tjetër publike,
- t'i përcaktojë qëllimet e pritshme për angazhimin e praktikantit, detyrat dhe procesin e punës së praktikantit, të cilat duhet të jenë publikisht të qasshme për kandidatët e interesuar në konkursin për punë të praktikantit,
- të nënshkruajë marrëveshje për punë të praktikantit me kandidatin e zgjedhur,
- të kryejë paraqitjen e praktikantit, të paktën një ditë, para fillimit të kryerjes së punës së praktikantit dhe ta çlajmërojë në afat prej tetë ditë pas përfundimit të punës së praktikantit, respektivisht pas pushimit të marrëveshjes për punë të praktikantit, në Agjencinë për Punësim të Republikës së Maqedonisë,
- të sigurojë person përgjegjës - mentor për mbikëqyrje të vazhdueshme të praktikantit, i cili do të organizojë punën e praktikantit, të ndjekë progresin e praktikantit dhe të sigurojë realizimin e qëllimeve për mësim dhe praktikë,
- të sigurojë mbikëqyrje mbi punën e praktikantit nga mentorin dhe të mos lejojë punën e pavarur të praktikantit,
- të sigurojë kushte optimale për punë dhe materiale dhe mjete për kryerjen e punës së praktikantit,
- t'i lëshojë praktikantit vërtetim për njohuritë e fituara, shkathësitë dhe kompetencat, si dhe përshkrim të punës së praktikantit dhe kohëzgjatjen e saj, në afat prej tetë ditë nga përfundimi i punës së praktikantit,

- rregullisht të paguajë kompensimin e përcaktuar në marrëveshjen për punë të praktikantit,

- të paguajë tatim mbi të ardhura personale për shumën e paguar të kompensimit,

- të sigurojë mjete për mbrojtje gjatë punës, nëse për vendin e punës në të cilin kryen punën e praktikantit është përshkruar të shfrytëzohen,

- të sigurojë fshehtësinë e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatësisë së praktikantit dhe

- të paguajë kontribut në bazë të invaliditetit dhe dëmtimit trupor të shkakuar me lëndim në punë ose sëmundje profesionale dhe kontribut plotësues për sigurim të detyrueshëm shëndetësor në rast të lëndimit në punë dhe sëmundjes profesionale.

(2) Punëdhënësi praktikantit nuk mund t'i arkëtojë shpenzime për trajnim, shpenzime për transport, për materiale pune dhe shpenzime të tjera në lidhje me kryerjen e punës së praktikantit.

(3) Punëdhënësi nuk mund t'i imponojë praktikantit të punojë detyra të cilat nuk janë përshkruar me marrëveshjen për punë të praktikantit.

IV. Marrëveshja për punë të praktikantit

Neni 12

(1) Marrëdhëniet, të drejtat dhe obligimet ndërmjet praktikantit dhe punëdhënësit rregullohen me marrëveshje për punë të praktikantit.

(2) Punëdhënësi është i obliguar të lidhë marrëveshje për punë të praktikantit me praktikantin në formë të shkruar, që duhet të nënshkruhet nga të dy palët, para fillimit të punës së praktikantit.

(3) Marrëveshjen për punë të praktikantit për person më të ri se 18 vjeç e nënshkruajnë praktikanti, prindi / kujdestari i tij dhe punëdhënësi.

(4) Marrëveshja për punë të praktikantit mund të nënshkruhet për orar pune të plotë ose orar pune jo të plotë, në pajtim me nevojat dhe vullnetin e palëve kontraktuese.

(5) Marrëveshja për punë të praktikantit nuk mund të lidhet për kryerjen e punëve dhe detyrave për vend pune të përhershëm konkret, për të cilin mund të lidhet marrëveshje për punësim, respektivisht praktikanti nuk mund të kryejë obligimet e punës të rregullta.

(6) Marrëveshja për punë të praktikantit nuk mund të lidhet me personin që paraprakisht ka qenë i punësuar të punëdhënësi i njëjtë apo punëdhënësi tjetër për vend pune me detyra të punës të njëjta apo të ngjashme si puna e praktikantit dhe marrëdhënia e punës të ketë zgjatur jo me pak se tre muaj.

(7) Me lidhjen e marrëveshjes për punë të praktikantit, praktikanti nuk i humb të drejtat në bazë të papunësisë, në pajtim me dispozitat e fushës së punësimit dhe sigurimit në rast të papunësisë dhe të drejta të përcaktuara në bazë të mbrojtjes sociale, të përcaktuara në pajtim me dispozitat e fushës së mbrojtjes sociale.

Përbajtja e marrëveshjes për punë të praktikantit

Neni 13

(1) Marrëveshja për punë të praktikantit i përmban elementet si në vijim:

1. Palët kontraktuese:

- praktikanti (emri dhe mbiemri, numri unik i amzës i qytetarit, data e lindjes, adresa e banimit, respektivisht vendqëndrimin, telefon, adresa elektronike, lloji dh shkalla e arsimimit) dhe

- punëdhënësi (emërtimi i plotë dhe i shkurtë, NUAS, viti i themelimit, emri dhe mbiemri i personit të autorizuar, adresa e subjektit juridik, veprimtaria kryesore, numri i të punësuarve),

2. Data dhe vendi i lidhjes së marrëveshjes,

3. Data fillestare dhe përfundimtare e punës së praktikantit,

4. Përshkrim i qëllimeve dhe procesi i fitimit të njohurive praktike dhe shkathtësive të praktikantit,

5. Lëndë e praktikës - përshkrim i detyrave të punës për të cilat do të punojë praktikanti,

6. Përshkrim i vendit të punës, kushtet për punë dhe rreziqet e mundshme për praktikantin,

7. Lartësia e kompensimit mujor për punën e praktikantit në pajtime nenin 8 paragrafi (2) të këtij ligji, që do t'i paguhet praktikantit në neto shumë në pajtim me marrëveshjen,

8. Orari ditor dhe javor i punës dhe numri i orëve të punës,

9. Obligimi për ruajtjen e sekretit afarist nga praktikanti dhe

10. Obligim i punëdhënësit për lëshimin e vërtetimit për fitimin e njohurive, shkathtësive dhe kompetencave të praktikantit, si dhe përshkrim i punës së praktikantit dhe kohëzgjatja e saj.

(2) Formën dhe përmbajtjen e vërtetimit nga paragrafi (1) pika 10 e këtij neni i përcakton ministri kompetent për punët nga fusha e punës.

Pushimi i marrëveshjes për punë të praktikantit

Neni 14

(1) Marrëveshja për punë të praktikantit pushon:

- me skadimin e afatit për të cilin është lidhur marrëveshja,

- ndërprerjen me marrëveshje,

- gjatë zvogëlimit të numrit të personave të punësuar me orar pune të pacaktuar te punëdhënësi gjatë angazhimit të praktikantit, nëse nuk e plotëson numrin e të punësuarve në afat prej 15 ditë nga dita e zvogëlimit të numrit të të punësuarve, përveç në rast të vdekjes ose pensionimit të personit të punësuar ose

- me punësimin e praktikantit.

(2) Praktikanti mund ta prishë marrëveshjen para skadimit të afatit për të cilin është lidhur, me deklaratë me shkrim pa obligim për shënimin e shkakut për prishjen e marrëveshjes, përveç në rast kur prishja mund të shkaktojë pasojë të dëmshme në punën e punëdhënësit ose mbi persona të tretë.

(3) Punëdhënësi mund ta prishë marrëveshjen për punë të praktikantit:

-me pushimin e kushteve të nevojshme për punë të praktikantit,

-kur do të konstatojë se praktikanti nuk i plotëson obligimet e kontraktuara ose

-me punësimin e praktikantit.

(4) Marrëveshja për punë të praktikantit mund të priset në afat prej të paktën pesë ditë nga dorëzimi i deklaratës me shkrim për prishje nga njëra palë kontraktuese te pala tjetër kontraktuese.

V. Evidenca për punën e praktikantit

Neni 15

Punëdhënësi është i obliguar të mbajë evidencë për orët e punës së praktikantit, në pajtim me evidencën për orarin e punës të të punësuarve.

Neni 16

Formën dhe përmbajtjen e sistemit për evidencë, si dhe ndjekjen dhe raportimin për punën e praktikantit i përshkruan ministri kompetent për punët nga fusha e punës.

VI. Zbatimi i rregullave të tjera

Neni 17

Për çështjet që dalin nga puna e praktikantit, dhe nuk janë rregulluar me këtë ligj, zbatohen dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet obligative, Ligjit për marrëdhënie pune dhe Ligjit për siguri dhe shëndet gjatë punës.

VII. Mbikëqyrja

Neni 18

(1) Mbikëqyrje mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji kryen Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

(2) Mbikëqyrje inspektuese kryhen Inspektorati Shtetëror i Punës, nëpërmjet inspektorëve të punës.

VIII. Edukimi, dispozita kundërvajtëse dhe barazimi

Edukimi

Neni 19

(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori i punës konstaton se është kryer parregullsi nga neni 9 paragrafi 1 alinetë 1, 2 dhe 3, neni 11 paragrafi (1), alinetë 1, 2 dhe 3, neni 13, neni 15 dhe neni 17 të këtij Ligji, është i detyruar të përpilojë procesverbal, në të cilin do të përcaktojë parregullsinë e kryer, me sugjerim për heqjen e parregullsisë së përcaktuar në afat prej tetë ditëve dhe njëkohësisht me dorëzimin e ftesës për kryerjen e edukimit të personit ose punëdhënësit ku është përcaktuar parregullsi gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(2) Formën dhe përmbajtjen e ftesës për edukim, si dhe mënyrën e zbatimit të edukimit i përcakton ministri kompetent për çështjet nga sfera e punës.

(3) Edukimin e organizon dhe r kryhen Inspektorati Shtetëror i Punës, në afat jo më të gjatë se tetë ditë nga dita e zbatimit të mbikëqyrjes inspektuese.

(4) Edukimi mund të zbatohet për më shumë parregullsi të njëjta ose identike të përcaktuara, për një ose më shumë punëdhënëse.

(5) Nëse në terminin e caktuar personi ose punëdhënësi mbi të cilin zbatohet edukimi, nuk paraqitet në edukim, do të konsiderohet se edukimi është kryer.

(6) Nëse personi ose punëdhënësi mbi të cilin zbatohet edukimi paraqitet në edukimin e caktuar dhe e përfundon atë, do të konsiderohet se është edukuar në lidhje me parregullsinë e përcaktuar.

(7) Nëse inspektori i punës gjatë zbatimit të mbikëqyrjes kontrolluese përcakton që parregullsitë e identifikuar nga paragrafi (1) i këtij neni janë hequr, miraton konkluzion me të cilin e ndërpret procedurën për mbikëqyrje inspektuese.

(8) Nëse inspektori i punës gjatë zbatimit të mbikëqyrjes kontrolluese përcakton se parregullsitë nga paragrafi (1) i këtij neni nuk janë hequr, parashtron kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse para komisionit për kundërvajtje.

(9) Inspektorati Shtetëror i Punës mban evidencë për edukimin e kryer, në mënyrën e përcaktuar nga ministri kompetent për çështjet nga sfera e punës.

Dispozita kundërvajtëse

Neni 20

(1) Gjohë në shumë prej 1.500 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:

- lidh marrëveshje për punë të praktikantit me praktikant që nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me dispozitat e këtij ligji (neni 3),

- siguron praktikant për nevojat e veta pa njoftim publik me përmbajtjen e parashkuar me dispozitat e këtij ligji ose organet e pushtetit shtetëror ose njësitë e vetëqeverisjes lokale nuk respektojnë përfaqësimin adekuat dhe të barabartë të pjesëtarëve të bashkësive dhe pjesëmarrjes së balancuar gjinore (neni 4),

- lidh marrëveshje për punë të praktikantit për kohëzgjatjen e punës së praktikantit në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji ose lejon punë të praktikantit disa herë me të njëjtin person (neni 6),

- angazhon një numër më të madh të praktikantëve nga numri i përcaktuar me dispozitat e këtij ligji (neni 7 paragrafët (1) dhe (2)),

- nuk i siguron praktikantit të drejtën për kompensim mujor dhe nuk i paguan kompensim mujor praktikantit në shumë neto për orar të plotë pune për punën e kryer praktike ose më të shkurtër se orari i plotë i punës në përputhje me dispozitat e këtij ligji (neni 8 paragrafët (1), (2) dhe (3)),

- nuk i paguan pjesë proporcionale si kompensim për kryerjen e punës së praktikantit në rast të mungesës nga puna për çfarë do arsye përveç pushimeve ose nuk e paguan kompensimin deri në 15-in të muajit aktual për muajin paraprak (neni 8 paragrafët 4 dhe 5)),

- para lidhjes së marrëveshjes për punë të praktikantit me shkrim nuk bën dhe nuk i jep praktikantit përshkrim të qëllimeve, detyrave dhe procesit të praktikës, nuk e njofton me kushtet për punën dhe rreziqet që lidhen me punën ose aktet e përgjithshme të punëdhënësit (neni 9 paragrafi (1) alinetë 1, 2 dhe 3),

- nuk i siguron praktikantit pushim ditor, javor dhe të paguar, nuk i siguron dhe nuk i paguan kompensim ose nuk i paguan kompensim të shpenzimeve në pajtim me këtë ligj (neni 9 paragrafi (1) alinetë 4, 5, 6 dhe 7),

- nuk publikon konkurs publik për nevojën e praktikës në faqen e vet të internetit ose në faqen e internetit të Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë ose media tjetër publike, nuk përcakton qëllimet e angazhimit, detyrave dhe procesit të punës së praktikantit (neni 11 paragrafi (1), alineja 1 dhe 2),

- nuk nënshkruan marrëveshje për punë të praktikantit me kandidatin e zgjedhur, nuk bën paraqitje për praktikantin dhe çlajmërim në afatin e caktuar, nuk siguron person përgjegjës - mentor për mbikëqyrje të vazhdueshme të praktikantit ose lejon punë të pavarur të praktikantit në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji (neni 11 paragrafi (1) alinetë 3, 4, 5 dhe 6),

- nuk i siguron praktikantit kushte dhe mjete për punë, nuk i jep vërtetim për njohuritë e fituara, aftësive dhe kompetencave në afatin e caktuar, nuk i paguan kompensim rregullisht në pajtim me marrëveshjen, nuk paguan tatim personal mbi të ardhurat në pajtim me ligjin, nuk siguron mjete për mbrojtje gjatë punës, sekret i të dhënave personale dhe mbrojtje e privatësisë, nuk paguan kontribute në bazë të invaliditetit dhe dëmtimit trupor të shkaktuar nga lëndimi në punë ose sëmundje profesionale dhe kontributin shtesë për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor në raste të lëndimit në punë dhe sëmundje profesionale (neni 11 paragrafi (1), alinetë 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13),

- i arkëton praktikantit shpenzime për trajnim, shpenzime për transport, për materialet e punës dhe shpenzime tjera lidhur me kryerjen e punës së praktikantit (neni 11 paragrafi (2)),

- mundëson punë të praktikantit pa marrëveshjen për punë të praktikantit me shkrim, mundëson praktikë për person më të ri se 18 vjeç me marrëveshje për punë të praktikantit të panëshkruar nga praktikanti dhe prindi ose kujdestari, mundëson me marrëveshje për punë të praktikantit të zëvendësohet vendi ekzistues i punës (neni 12 paragrafët (1), (2), (3) dhe (5)),

- nënshkruan marrëveshje për punë të praktikantit me përmbajtje në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji (neni 13),

- nuk e pranon deklaratën me shkrim për prishjen e marrëveshjes për punë të praktikantit, nuk e prish marrëveshjen për punë të praktikantit në afatin e dhënë, e prish marrëveshjen për punë të praktikantit në kundërshtim me këtë ligj (neni 14 paragrafët (2) dhe (3)) dhe

- mban në mënyrë të parregullt ose nuk mban evidencë të orëve të punës së praktikantit (neni 15).

(2) Gjohë në shumë prej 30% të gjohës së përcaktuar për personin juridik do t'i shqiptohet si shkelje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në person juridik.

(3) Gjohë në shumë prej 150 deri 250 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni punëdhënësit - person fizik.

Gjohë për person të autorizuar zyrtar

Neni 21

Gjohë në shumë prej 50 deri 100 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar zyrtar nga organi që e mban procedurën dhe organi publik kompetent nga i cili janë kërkuar dëshmitë dhe të dhënat, nëse:

- nuk mban evidencë për orët e punës së praktikantit në përputhje me këtë ligj (neni 15).

Barazimi

Neni 22

(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese për zbatimin e këtij ligji konstatohet shkelje që është përcaktuar si kundërvajtje me këtë ligj, nga personi i autorizuar zyrtar detyrimisht do ti ofrohet procedurë për barazimin e kryerësit të kundërvajtjes në pajtim me Ligjit për kundërvajtjet.

(2) Formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës për kundërvajtje dhe urdhërpagesës mandatore, i përcakton ministri kompetent për çështjet nga sfera e punës.